



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
ADMINISTRATORI**

Nr. prot

Gjirokastër, më _____.____.2022

NJOFTIM

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër mbështetur në VKM Nr. 40 datë 23.01.2019 Për Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 269 datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit" të ndryshuar VKM Nr. 39 datë 23.01.2019 Për Disa ndryshime në Vendimin Nr. 903, date 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë" të ndryshuar.

NJOFTOHEN TË GJITHË STUDENTËT QË JANË TË INTERESUAR PËR:

A. BURSË FINANCIARE DHE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT

1. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike.
2. Student që vjen nga shtresa sociale: Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë.
3. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, person me aftësi të kufizuara.
4. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili i ka të dy prindërit me aftësi të kufizuara
5. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, me prind bashkëjetues pensionist dhe prindi tjetër i është ndarë nga jeta.
6. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili i ka të dy prindërit pensionistë.
7. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili është i treti e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë.

8. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.
9. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç.
10. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore deri në moshën 25 vjeç.
11. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

B. VETËM PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT

1. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët romë dhe egjiptianë.
2. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

ADRESA: RRUGA "STUDENTI" GJIROKASTËR, WEB: WWW.UOGJ.EDU.AL

BIBLIOTEKA E UGJ-SË

ZJ. IRENA DINE

STUDENTËT TË DORËZOJNË:

Dokumentacionin provues të kriterit përkatës në formatin

- FORMULARI PËR PËRFITIM BURSE DHE/OSE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

- FORMULAR DEKLARIMI

- DOKUMENTACIONI PROVUES

Kërkesa dhe formulari i deklaramit gjenden dhe shkarkohen nga website zyrtar i institucionit në seksionin Bursa formati pdf.

Dokumentacioni i përgatitur dhe i renditur sipas formularit të Aplikimit të dorëzohet nga vetë studenti, për studentet me aftësi të kufizuara nga kujdestari përkatës.

Dokumentacioni të jetë origjinal ose i noterizuar (përveç dokumentacionit të marrë nga e albania).

STUDENTËT ME MESATARE 9 (NËNTË) -10 (DHJETË)

- Studentët e pranuar në vitin e parë akademik “Bachelor” 2020-2021 me notë mesatare 9(nëntë) -10 (dhjetë), listat e këtyre studentëve në bazë të notës mesatare përkatëse do të përcillen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Këta studentë duhet të dërgojnë me shërbimin postar vetëm fotokopje të kartës së identitetit dhe nr personal bankar.
- Studentët që ndjekin studimet, në vitet pas të parit, të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, me notë mesatare vjetore e ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) përgatiten nga insitucioni (sekretaria mësimore) dhe terhiqen në formë vërtetimi pranë saj.

Studentët që paraqesin kërkesat nga data 21.10.2022 deri 31.10.2022 dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara, do të përfitojnë bursë financiare nga data e fillimit të vitit akademik 2022-2023. Kërkesat e studentëve të dorëzuara pas datës 31 tetor 2022, do të përfitojnë bursë financiare në muajin pasardhës nga data e dorëzimit të dokumentacionit, sipas përcaktimeve në VKM-t përkatëse.

A D M I N I S T R A T O R

Semi GOLEMI